



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:044580

Datë: 12.02.2024

Numri i dokumentit: 05314916

PA1.nr. 699/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Skender Çoçaj, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Mehmet Ndrecaj, anëtarë, me praktikantin gjyqësor Arben Arifi, si procesmbajtës, në lëndën penale ndaj të akuzuarit Xh.K., nga Peja, për shkak të veprës penale Cenimi i të drejtave nga marrëdhënia e punës nga neni 218 par.1 të KPRK-së, për të vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të akuzuarit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Pejë, P.nr. 277/2020 të datës 16.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 05 Shkurt 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit Xh.K., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr. 277/2020 të datës 16.05.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë, P.nr. 277/2020 të datës 16.05.2023, i akuzuari Xh.K., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale Cenimi i të drejtave nga marrëdhënia e punës nga neni 218 par.1 të KPRK-së, për të cilën i është shqiptuar vërejtje gjyqësore.

I akuzuari është obliguar që të paguaje shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 30 (tridhjetë) euro, në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 20 (njëzet) euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumen prej 30 (tridhjetë) euro e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Pala e dëmtuar H.L., për realizimin e kërkesës pasuare juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar :

Mbrojtësi i të akuzuarit Xh.K. – av.Mustafë Kastrati nga Peja, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plote të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin, duke propozuar që aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet dhe i akuzuari në mungesë të provave të lirohet nga akuza apo aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u shkjaruar përkitazi me ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit Xh.K., me shkresën e vet PPA.II.nr.734/23 të datës 08.06.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit ta refuzojë si të pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në pajtim me nenin 390 paragrafi 1 të KPPRK-se, në të cilën nuk i ftoi palët ngase në rastin konkret kemi të bëjmë me vërejtje gjyqësore dhe njoftimi i palëve nuk është i obliguar.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit Xh.K., dhe gjeti se :

- Ankesa nuk është e bazuar.

Sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale mbrojtësi i të akuzuarit Xh.K., av.Mustafë Kastrati, me ankesë pretendon se aktgjykimi shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 1 nën par.1.12 e lidhur me nenin 369 par.6 dhe 7 të KPPRK-së, me arsyetim se dispozitivi i aktgjykimit të kontestuar është i pakuptueshëm, është kundërthënë në brendinë e tij dhe me arsyet e paraqitura në arsyetimin e aktgjykimit. Sipas mbrojtësit në aktgjykim nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare ndërsa arsyet e paraqitura janë plotësisht të paqarta dhe në masë të konsiderueshme kundërthënëse. Sipas mbrojtësit të të akuzuarit Gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar nuk i ka paraqitur në mënyrë të plote faktet e vërtetuara dhe të pa vërtetuara, e të cilat shkelje aktgjykimin e shkallës së parë e bëjnë të paqëndrueshëm për çka të njëjtin duhet anuluar. Gjithashtu pretendon se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në kundërshtim me nenin 385 par.1 nën par.1.1 dhe 1.2 të KPPRK-së ngase kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor e ka shkelur ligjin penal në dëm të të akuzuarit ngase veprimet e të akuzuarit nuk paraqesin vepër penale, kjo nga shkak se mungon pasoja ngase e dëmtuara asnjëherë nuk e ka zbatuar vendimin e drejtorit dhe nuk ka punuar në ndërrimin e caktuar nga udhëheqësi i institucionit pra nuk janë plotësuar elementet esenciale të veprës penale, dashja dhe pasoja.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtësit të të akuzuarit Xh.K., lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe konstatoi se të njëjtat nuk janë të bazuara ngase aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm dhe si i tillë përmban arsye të mjaftueshme përkitazi me faktet relevante të kësaj çështje juridiko penale si dhe faktet nga të cilat varet edhe aplikimi i drejte i dispozitave të ligjit penal. Theksimet e lartpërmendura në ankesë nuk janë të natyrës së tillë për të konstatuar se aktgjykimi përmban mangësi të atilla procedurale që do ta bënin të paqëndrueshëm ligjshmërinë e tij. Gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejte dhe të plote i ka vërtetuar të gjitha faktet vendimtare të kësaj çështje dhe se është

mbështetur ne provat e administruara si dëgjimi i të dëmtuarës H.L., ne cilësinë e dëshmitares ne shqyrtimin gjyqësor te datës 16.01.2023, e cila ka deklaruar se ne Qendrën Burimore është duke punuar që 7 vite dhe fillimisht e ka pasur orarin e punës prej 08:00 deri ne orën 16:00 e pastaj prej orës 11:00 deri ne orën 19:00 dhe se kontratën e punës e ka pasur per 8 orë pune në ditë, e ne te cilën qendër ekziston ndërrimi i natës që janë motrat dhe rojet me ndërrime e pastaj drejtori ka bërë ndryshimin e orarit ku të dëmtuarën e ka caktuar edhe ne ndërrimin e natës për të cilën ajo nuk ka dalur asnjëherë për çka edhe ka bërë ankesë ne Inspektorat dhe Inspektorati i punës i ka dhënë të drejtë se ne bazë të kontratës nuk ka të drejtë të punojë në ndërrimin e natës. E dëmtuara ka deklaruar se ne orarin e natës punojnë motrat konviktore ndërsa procesi edukativ te cilës i përket e dëmtuara fillon ne orën 08:00 dhe përfundon ne orën 19:00, pastaj administroi edhe provat e tjera si dëgjimin e dëshmitarëve Sh.M., A.B., I.M., G.T., A.K., kontratën e punës per te dëmtuarën H.L., me numër 3/1048-196 të datës 15.09.2016 si dhe të gjithat provat e tjera më afër të përshkuara ne faqen 10 dhe 11 të aktgjykimit të ankimuar të gjykatës se shkalles se pare dhe në bazë të kësaj pretendimet ankimore lidhur me mos vërtetimin e fakteve vendimtare lidhur me këtë çështje dhe shkeljen e ligjit penaë, Gjykata e Apelit i refuzoi si te pabazuara.

Sa i përket vërtetimit te gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike, mbrojtësi i të akuzuarit Xh.K., pretendon se si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes se ligjit penal ne dëm të të akuzuarit ka ardhur deri te vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike ngase nuk është vërtetuar fakti se i akuzuari e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor, siç është pretenduar në aktakuzë ngase ne rastin konkret i akuzuari ne cilësinë e drejtorit të institucionit i ka zbatuar ligjet dhe aktet normative ne fuqi si dhe udhëzimet nga Ministria e Arsimit dhe ka pasur për detyrë të sigurojë mbikëqyrjen 24 orë per personat me nevoja të veçanta pra, ne veprimet e të të akuzuarit nuk ka veprim të kundërligjshëm per sistemin e punëtorëve brenda institucionit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerësoi pretendimet ankimore te mbrojtësit të të akuzuarit lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike dhe konstatoi se te njëjtat nuk janë te bazuara ngase janë ne kundërshtim me provat e administruara si : dëgjimi i të dëmtuarës H.L., ne cilësinë e dëshmitares ne shqyrtimin gjyqësor te datës 16.01.2023, e cila ka deklaruar se ne Qendrën Burimore është duke punuar që 7 vite dhe fillimisht e ka pasur orarin e punës prej 08:00 deri ne orën 16:00 e pastaj prej orës 11:00 deri ne orën 19:00 dhe se kontratën e punës e ka pasur per 8 orë pune në ditë, e ne te cilën qendër ekziston ndërrimi i natës që janë motrat dhe rojet me ndërrime e pastaj drejtori ka bërë ndryshimin e orarit ku të dëmtuarën e ka caktuar edhe ne ndërrimin e natës për të cilën ajo nuk ka dalur asnjëherë për çka edhe ka bërë ankesë ne Inspektorat dhe Inspektorati i punës i ka dhënë të drejtë se ne bazë të kontratës nuk ka të drejtë të punojë në ndërrimin e natës. E dëmtuara ka deklaruar se ne orarin e natës punojnë motrat konviktore ndërsa procesi edukativ te cilës i përket e dëmtuara fillon ne orën 08:00 dhe përfundon ne orën 19:00, pastaj administroi edhe provat e tjera si dëgjimin e dëshmitarëve Sh.M., A.B., I.M., G.T., A.K., kontratën e punës per te dëmtuarën H.L., me numër 3/1048-196 të datës 15.09.2016 si dhe të gjithat provat e tjera më afër të përshkuara ne faqen 10 dhe 11 të aktgjykimit të ankimuar të gjykatës se shkalles se pare, e ne baze te te cilave konstatohet se gjykata e shkalles se pare, drejte dhe ne mënyre te plote ka vërtetuar gjendjen faktike ne rastin konkret, andaj edhe pretendimet ankimore lidhur me vërtetimin e gabuar dhe jo te plote te gjendjes faktike i refuzoi si te pabazuara si dhe konstatoi se ne rastin konkret kur i akuzuari është shpallur fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar, drejte është aplikuar edhe ligji penal, për çka edhe pretendimet e mbrojtësit lidhur me shkeljen e ligjit penal në dëm të të akuzuarit i refuzoi si të pabazuara ngase ne veprimet e te akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet subjektive dhe

objektive të veprës penale Cenimi i të drejtave nga marrëdhënia e punës nga neni 218 par.1 të KPRK-së, për të cilën është shpallur fajtor, ngase me veprimin e tij e ka caktuar të dëmtuarën të punojë edhe në ndërrimin e natës e që kjo nuk ka qenë e paraparë me kontratën të cilën e ka lidhur e dëmtuara me rastin e themelimit të marrëdhënies së punës.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, mbrojtësi i të akuzuarit Xh.K., me ankesë nuk e atakon aktgjykimin lidhur me këtë baze ankimore ngase pretendon se i akuzuari nuk e ka kryer veprën penale dhe se i njëjti duhet të lirohet në mungesë të provave, megjithatë Gjykata e Apelit e vlerësoi edhe në këtë aspekt dhe konstatoi se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes në lidhje me sanksionin penal ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe renduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së e të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, me bindje se me dënimin e shqiptuar – vërejtje gjyqësore nga ana e Gjykatës së shkallës së parë, do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerëses nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i saj, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.699/23 më 05.02.2024

Procesmbajtës
Arben Arifi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetar i kolegjit
Skender Çoçaj

Mehmet Ndrecaj
